



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1434/2 Prot.

Gramsh, më 08.04. 2022

VENDIM

Nr. 40 Datë 08/04/2022

Për

Miratimin e kontratës së **“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Gramsh”** në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit”, midis Bashkisë Gramsh dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 08.04.2022, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, bazuar në:

Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8, 9, 54 të tij;

Ligjin Nr.10463 datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar;

Ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenet 9 e 11;

VENDOSI

1. Të miratojë lidhjen e kontratës së **“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Elbasan”**, në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit”, midis Bashkisë Gramsh dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., sipas draftit bashkangjitur.
2. Efektet financiare të zbatimit të kësaj marrëveshje mbulohen nga buxheti i bashkisë i miratuar për vitin 2022 me vendimin e Këshillit Bashkiak nr.127 datë 29.12.2021.
3. Ngarkohen Kryetari dhe Administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT  
Xhulia GJINI

Konc.Xh.Gjini  
Miratoi G.Lena  
Dosja \_\_\_\_\_  
Afati \_\_\_\_\_

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Greta LENA

